



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE
NJËSIA PËR SIGURIMIN E BRENDSHËM TË CILËSISË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE
HUMANE
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**

GRUPI I NJSBC

- | | |
|-------------------------------------|-------------------|
| 1- Departamenti i Shkencave Sociale | Dr. Maria Dojce |
| 2- Departamenti i Biologji-Kimi | Dr. Rezana Pengu |
| 3- Departamenti i Matematikë-Fizikë | Msc. Sivja Cobani |
| 4- Departamenti i Infermierisë | Msc. Paola Saro |
| 5- Romina Xhaferi (Studente) | |

VITI AKADEMIK 2021- 2022

PARIMET E PUNËS SË NJSBC

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL realizojnë vlerësimin e brendshëm me synimin që të krijohet një pamje e qartë dhe transparente e njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të IAL-së dhe të programeve të studimit.
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në IAL si pjesë e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumente, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

PJESA PËRSHKRIMORE DHE ELEMENTËT SHPJEGUES

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor,

- të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;
- të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor , si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.

Nëpërmjet këtij raporti NJSBC do të evidentojë përmbushjen e standardeve të cilësisë për të gjitha fushat e vprimtarisë së UNIKO. Informacioni dhe të dhënat që do të nxirren nëpërmjet këtij raporti do të shërbejnë si indikatorë për përmirësimin e veprimtarisë së njësive kryesore dhe atyre bazë në UNIKO, si dhe do të vendosen në dispozicion të proceseve të vlerësimit të jashtëm institucional ose të programeve të studimit.

ELEMENTËT SHPJEGUES

SHKURTESA:

HYRJE

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve profesionale, referuar Nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, programeve të ciklit të parë të studimit “Bachelor” dhe programeve të ciklit të dytë “Master” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Universiteti “Fan S. Noli” në Korçë, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, të përgatisë një raport i cili do të shërbejë si bazë për grupin e vlerësimit të jashtëm, gjatë procesit të akreditimit.

Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, NJSBC është bërë pjesë e trajnimeve paraprake të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit, mbi bazën e përvojës së vlerësimeve të mëparshme, duke hartuar edhe një plan pune, duke ndarë detyrat dhe duke udhëzuar NJSBC për përmbushjen e detyrave.

Për hartimin e këtij raporti, NJSBC ka mbajtur parasysh raportin e viteve të kaluara, si dhe raportin e GVJ që është realizuar në kuadër të akreditimit institucional.

Gjithashtu u shfytëzuan të gjitha materialet, të dhënat e Fakultetit, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën. Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e

- Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane:**
- Ligj nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
 - Standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve
 - Raporti i Vlerësimit Institucional i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë Prill 2017
 - Analiza e punës mësimore–shkencore 2018-2019 për Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë • Udhëzimet e MASR-së
 - Dokumente të veprimtarisë institucionale të Universitetit “Fan S. Noli”, më konkretisht:
 - Statuti i UK-së,
 - Rregullore e UK-së,
 - Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë
 - Rregulloret e Programeve të studimit
 - Rregullore e transferimeve - Rregullore ESSE3
 - Planet mësimore - Formularët e ngarkesës vjetore të stafit

Gjatë vitit akademik 2011-2012, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (FSHNH) u përcaktua si një njësi e re dhe tepër e rëndësishme e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë. Në zbatim të Urdhërit nr. 16, datë 17.1.2012 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës dhe në nenin 41 të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” u bë riorganizimi i Fakultetit të Mësuesisë i themeluar në vitin 1992, në dy Fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
2. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

Aktualisht, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ka në përbërje të tij pesë Departamente: 1) Shkencat sociale, 2) Infermieri, 3) Matematikë-Fizikë, 4) Informatikë, 5) Biologji dhe Kimi. Në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, stafi i kualifikuar, mjediset, infrastruktura dhe pajisjet në shërbim

të studentëve mundësojnë plotësimin e kërkesave për zhvillimin e duhur të procesit mësimor dhe realizimin e kërkimit shkencor. Të gjitha këto përbëjnë kyçin e suksesit tonë në përgatitjen e profesionistëve në fushën e Filozofisë dhe Sociologjisë, specialistëve të administrimit dhe politikave sociale, mësuesve profesionistë të Shkencave Sociale, të specialistëve të Matematikë-Fizikë, Informatikës, të Biologji - Kimisë, profesionistëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Infermierëve të përgjithshëm dhe Mami, me një nivel të lartë shkencor, me dije bashkëkohore dhe me mundësi punësimi shumë të larta.

Reforma më e madhe arsimore e kryer së fundmi është strukturimi i programeve të studimit në përputhje me parimet e hedhura në Deklaratën e Bolonjës dhe në të gjitha dokumentat e tjera pasuese, të cilat gjejnë pasqyrimin e tyre në Ligjin Nr.9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në amendamentet e pasqyruara në ligjin Nr.10307, datë 22.07.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9741”, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kështu sot në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane arsimimi është i organizuar në dy cikle, duke ofruar dy nivele diplomash; lëndët janë të organizuara në module dhe ngarkesa e tyre shprehet në kredite; programet e studimit janë të gjitha bashkëkohore. Ato ndjekin programet e studimit të fakulteteve homologe, në Shqipëri dhe Rajon.

Në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, duke filluar nga viti akademik 2018-2019, funksionon dhe një Program Profesional 2-vjeçar “Shërbim social”.

Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën përkatëse dhe suplementin e diplomës apo me certifikatën përkatëse; studentët kanë mundësinë e transferimit të krediteve nga një Institucion tjetër i Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe të pajisen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për t’u larguar nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane në një IAL tjetër.

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ka pësuar përmirësime dhe zhvillim edhe në drejtimin institucional, duke u organizuar mbi bazën e Departamenteve dhe funksionimin e organeve kolegjiale në vendimmarrje.

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ka patur një dinamikë të lartë zhvillimi në vitet e fundit: në drejtim të zhvillimit të programeve në të dy ciklet e studimit, duke krijuar programe krejtësisht të reja dhe rikompozim të përgjithshëm, të kujdesshëm të atyre ekzistues në përputhje me kërkesat e reformës së Bolonjës dhe në drejtim të rritjes së numrit të studentëve, rritjes së stafit akademik në numër dhe në kualifikim dhe të atij ndihmës.

Gjithashtu Fakulteti ka një bashkëpunim shumë të frytshëm me mjaft Universitete dhe Fakultete homologe në Rajon dhe në Europë.

Misioni parësor i Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, është përgatitja dhe formimi cilësor i studentëve në të gjitha ciklet e studimit që Fakulteti ofron si dhe kërkimi shkencor në fushat përkatëse.

Studimet në këtë Fakultet organizohen me kohë të plotë në dy cikle: cikli i parë "Bachelor"; cikli i dytë: "Master Profesional" “ Master nw Mwsuesi” dhe "Master Shkencor" mbështetur në Deklaratën e Bolonjës.

Fakulteti ofron programin profesional “Shërbim Social” të organizuar në 2 vite akademike, për të plotësuar kërkesat në fushën e shërbimit social.

OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E NJSBC

Në përfundim të analizës së punës mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2021-2022 u hartuan disa rekomandime për t’u pasur në konsideratë gjatë vitit akademik 2022-2023. Rekomandimet u mbështetën tek plani strategjik afatgjatë i institucionit dhe tek objektivat dhe qëllimet e njësive bazë dhe të njësisë kryesore. Mbështetur tek rekomandimet dhe problematikat e përfshira në raportin e analizës vjetore të vitit të kaluar, në analizë është përfshirë një informacion mbi strategjitë e ndërmarra për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit, si dhe për përmbushjen e rekomandimeve dhe për eliminimin e disa prej pikave të dobëta të brendshme potenciale.

Përgjatë vitit akademik 2021-2022 është **thelbësor për t’u theksuar** fakti që ka qenë një vit post-pandemik, ku vështirësi të pasuara nga periudha e pandemisë po pasqyrohen në një corroditje të kërkesës së studenteve ndaj programeve të studimit (vihet re një pasiguri dhe hezitim i të rinjve për t’u regjistruar në programet aktuale dhe rritja e pasigurisë ndaj tregut të punës), largimi jashtë vendit dhe braktisja e studimeve duke i lënë ato të papërfunduara, mungesën e vigjilencës studentore ndaj procesit mësimor, dhe hezitimin për të aplikuar në projekte të ofruara në mënyrë periodike në website të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë ose rrjetet sociale të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane.

Bazuar në specifikat e lartpërmendura, dekanati dhe njësitë e FSHNH reagues në përmirësimin e situatës së pari duke u bazuar në punën konkrete të njësive (departamenteve përkatëse), stafit akademik dhe atij mbështetës dhe partnerëve.

Në departamentin e Shkencave Sociale u ngrit një grup brenda njësisë për të realizuar një studim mbi kërkesën e tregut të punës dhe preferencave të maturantëve për studimet universitare, me qëllim të inicimit të çdo risie që i paraprin tregut të punës dhe preferencave të maturantëve ndaj programeve prioritare të studimit.

Në fushën e kualifikimit shkencor nuk u realizua asnjë mbrojtje teze doktorale nga pedagogë të departamenteve. Megjithatë, edhe pse në kushte të vështira të zhvillimit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, pati disa arritje në fushën e kualifikimit profesional të pedagogëve dhe të veprimtarisë të njësisë kryesore (FSHNH-së) në drejtimin e përmirësimit dhe të inovacionit, të cilat përshkruhen më poshtë.

Vlen të theksohet se realizmi i praktikave institucionale dhe profesionale që janë pjesë e pesë njësive bazë të studimit, kërkuan angazhimin maksimal të të gjithë pedagogëve dhe komunikim shumë intensiv me institucione në Qarkun e Korçës. Gjithashtu, platformat online ndihmuan edhe në përcjelljen e literaturës dhe në përditësimin e kontakteve dhe informacionit mes pedagogëve dhe studentëve.

Shënim:

Pjesa më poshtë sipas standarteve do të jepet në formë analitike, përmbushja ose jo e Standardit do të jepet duke bërë edhe analizat përkatëse se deri në çfarë niveli përmbushet Standardi, ku ka vend për përmirësim, veprimet që duhet të ndërmeren për të ndryshuar ose përmirësuar etj., dokumentet mbështetëse për sa më sipër do të vihen të gjitha në pjesën II (Tregues të Matshëm), dhe numri i tabelës dhe faqes ku mund të gjendet në këtë dokument, do të përfshihen në këtë pjesë.

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1

Njësia e institucionit të arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Elementë referues të raportit

- Përputhja e programeve me qëllimet dhe misionin;
- Programe të akredituara, organizimi, kreditet, kompetencat (nëse i kanë të përcaktuara);
- Hartimi në përputhje me nevojat e tregut dhe me zhvillimin ekonomik.

Analiza

Programet e studimit të ofruara në FSHNH janë hartuar në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe në harmoni me standartet e konventës së Bolonjës. Konkretisht:

A) Departamenti i Shkencave Sociale disponon 6 (gjashtë) programe studimi aktive, të organizuara në dy cikle, (2) bachelor, (3) master dhe (1) program 2-vjeçar me karakter profesional:

- 1) Bachelor “Administrim dhe politika sociale” (180 kredite)
- 2) Bachelor “Filozofi-Sociologji” (180 kredite)
- 3) Master në Mësuesi “Mësues në shkencë sociale” (120 kredite)
- 4) Master profesional “Administrim publik” (60 kredite)
- 5) Master shkencor “Filozofi sociale” (120 kredite)
- 6) Program profesional 2-vjeçar “Shërbim social” (120)

B) Departamenti i Infermierisë disponon 3 (tre) programe studimi aktive, të organizuara në dy cikle, bachelor dhe master:

- 1) Bachelor “Infermier i Përgjithshëm” (180 kredite)
- 2) Bachelor “Mami” (180 kredite)
- 3) Master profesional “Infermieristikë” (60 kredite)

C) Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë disponon 2 (dy) programe studimi aktive, të organizuara në dy cikle, bachelor dhe master:

- 1) Bachelor “Biologji-Kimi” (180 kredite)

2)) Master në Mësuesi “Mësues në Biologji dhe Kimi” (120 kredite)

D) Departamenti i Informatikës disponon 2 (dy) programe studimi aktive, të organizuara në dy cikle, bachelor dhe master:

1) Bachelor “Teknologji Informacioni” (180 kredite)

2) Master profesional “Sistemet Moderne të Telekomunikacionit dhe Teknologjitë e Internetit” (60 kredite)

E) Departamenti Matematikë-Fizikë disponon 3 (tre) programe studimi aktive, të organizuara në dy cikle, bachelor dhe master:

1) Bachelor “Matematikë-Fizikë” (180 kredite)

2) Bachelor “Matematikë-Informatikë” (180 kredite)

3)) Master në Mësuesi “Mësues në Matematikë dhe Informatikë-Fizikë” (120 kredite)

Shtojca Anex I. Dok. 1.3. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve;

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Duke marrë parasysh ndryshimin e vullshëm të tregut të punës, rekomandojmë që të shtohet si njësi paralele në fakultet grupi i hulumtimit dhe analizës së tregut të punës, i cili të krijojë mundësinë e matjes së here pas here të programeve aktive dhe kërkesës së tregut të punës.

Programet e studimit që ofrohen në FSHNH si ofertë akademike, plotësojnë kërkesat e maturantëve për të vazhduar studimet në këto drejtime dhe vlerësimin të stafit drejtues për nevojën e plotësimit të ofertës së institucionit me programe në këto fusha studimi që çojnë kryesisht në profesionin e mësuesisë sipas kriterëve të LPAL¹.

Aktiviteti I FSHNH-së në kuadrin e UNIKO-s si institucion i arsimit të lartë mbështetet në një pamje të hapur të bashkëpunimit dhe partneritetit me institucionet arsimore dhe

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të njësisë të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Elementë referues të raportit

- Përputhja e programeve me strategjinë për zhvillim të IAL dhe studimin e tregut.

UNIKO synon të realizojë në mënyrë të vazhdueshme misionin e tij për arsimin e lartë, si një e mirë dhe përgjegjësi publike. Konkretisht, synon të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; si dhe të

¹ Anex II. Dok. 2.1. Ligji për arsimin e lartë në RSH, Nr. 80/2015, Neni 83.

kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, në nivel kombëtar dhe rajonal, duke kontribuar kështu në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare.

Analiza Programet përputhen më së miri me fushat strategjike të strategjisë së zhvillimit të institucionit.² Fushat e studimit për këto programe, përkojnë me drejtimit e kërkimit shkencor në UNIKO³.

Programet e studimit synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneesh e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;^{4,5}

Shtojca¹ Anex I. Dok. 1.8. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020

¹ Anex II. Dok. 2.1. Ligji për arsimin e lartë në RSH, Nr. 80/2015, Neni 83.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi II.1

Standardi II.1 - Programet e studimit synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës

Elementë referues të raportit

- Mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; Kërkesat e punëdhënësve;
- Numri i pritshëm i studentëve që mund të regjistrohen në program;
- Numri i të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet si motra.

Analiza

Bazuar në mundësitë aktuale të tregut të punës studentët e FSHNH informohen në mënyrë periodike lidhur me mundësitë e këmbimit të përvojave studentore nepërmjet programeve të unionit europian dhe më gjere. Nga ana tjetër, pedagogët qëndrojnë vazhdimisht në kontakt me kompanitë dhe institucionet repektive të tregut të punës, dhe ndryshimet e mundëshme të kerkesës dhe ofertës pasqyrohen në kohë rekord tek programet përkatëse.

Bazuar në dokumenta strategjike të hartuar nga organizma ndërkombëtare dhe ato kombëtare, në frymën e Samiteve të Lisbonës dhe Kopenhagës, dokumentit të zhvillimit i BE-së 'Evropa 2020', Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020, Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale (DPPS) 2015-2020, dokumente dhe iniciativa që lidhen me politika sociale, të konkureshme dhe efektive, si dhe me adminstrimin e tyre, i japin një përparësi formimit profesional në fushat perkatese. E orientuar drejt këtyre dokumenteve strategjike dhe nevojave të tregut, UNIKO i ka dhënë një rëndësi te vecante informimit dhe perfshirjes se studenteve, duke mbështetur hapjen e programeve të studimit që lidhen me nevojat e tregut. 6

² Anex I. Dok. 1.5. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, (Fusha strategjike: Edukimi. fq.21)

³ Anex I. Dok. 1.6. <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor>

⁴ Anex I. Dok. 1.7. Rregulloret e programit të studimit sipas degëve;

⁵ Anex I. Dok. 1.8. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Gjatë dekadës së fundit vendi ynë po përballlet me ndryshime demografike (popullsi në plakje, përqindje të ulëta të lindjeve, ndryshime në strukturën e familjes dhe migracioni), madje për herë të parë në historinë e Shqipërisë në zonat urbane jeton shumica e popullsisë. Në studimet e tregut të realizuar nga departamente te FSHNH por dhe nga vetë angazhimi i institucioneve qeveritare në vend është shprehur dukshëm rëndësia e sektorit të politikave sociale në ecurinë e vendit drejt integritit si shtet anëtar në BE, por dhe forcon aftësitë dhe kapacitetet e individëve, në përshtatjen e tyre me mundësitë e reja të rritjes ekonomike dhe zhvillimeve të jetës sociale.

Standardi II.2

Standardi II.2 - Programet e studimit synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare

Analiza programet e studimit përshtaten dhe përditësohen në mënyrë periodike me të gjitha nevojat e paraqitura ose të identifikuara në tregun e punës dhe shoqëri.

UNIKO synon të realizojë në mënyrë të vazhdueshme misionin e tij për arsimin e lartë, si një e mirë dhe përgjegjësi publike. Konkretisht, synon të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; si dhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, në nivel kombëtar dhe rajonal, duke kontribuar kështu në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare.

Rekomandime të NJSBC:

Të vazhdojë rritja e cilësisë së mësimdhënies duke shfrytëzuar më mirë bazën materiale dhe didaktike në dispozicion të stafit dhe studentëve.

2. Duhet të synohet më tepër në rritjen e mëtejshme të produktivitetit të metodave të të nxënimit si dhe zhvillimi më i mirë dhe i kontrolluar i praktikave profesionale.
3. Të vazhdojë organizimi i Aktiviteteve nga ana e Departamenteve, me synim përfshirjen e studentëve në veprimtari të ndryshme kulturore, sociale dhe shkencore.
4. Është për t'u vlerësuar angazhimi dhe pjesëmarrja në projekte si nga pedagogët e departamenteve ashtu edhe nga studentët. Duhet punuar më shumë në përfshirjen e studentëve në projekte konkrete.
5. Shihet si domosdoshmëri të intensifikohet rritja e bashkëpunimit, aplikimit dhe pjesëmarrjes në projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare nga ana e Departamenteve, duke nxitur trajnimin dhe rritur nivelin e ekspertizës së aplikimeve.

Realizimi i këmbimit studentor dhe stafit pedagogjik me univeritete analoge brenda vendit ose në rajon.

Standardi II.3 - Njësia, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre

Elementë referues të raportit

- Metodologjitë e vlerësimit të njësisë, instrumentet matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; Përfshirja e këtij informacioni në vetëvlerësimin institucional;
- Publikimi i rezultateve të pritshme, të vlerësimit dhe rezultatet që synohen të arrihen;
- Metodrat që përdoren për kryerjen e vlerësimit, të tërthorta ose të drejtpërdrejta:

Të tërthorta:

Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimit, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista;

Të drejtpërdrejta:

Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; Provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatat); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës;

Analiza

Tabela .., faqe..

Shtojca

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi II.4 - Programet e studimit janë të detajuara dhe informuese

Elementë referues të raportit

- Informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve; lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër; Ngarkesa mësimore, orët në auditor, frekuentimi/ ndjekja e programeve; Syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Analiza

Elementët përbërës të planit mësimor, si ngarkesa mësimore, orët në auditor dhe jashtë tij, frekuentimi i lëndës dhe vlerësimi gjatë lëndës, u bëhen të njohura studentëve me fillimin e studimeve në programin 'Administrim dhe politika sociale'. Gjithashtu, në fillim të çdo moduli, pedagogët prezantojnë tek studentët programet lëndore (syllabuset e detajuara), kreditet, formën e kontrollit të dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, si dhe objektivat formues dhe kompetencat profesionale.

Informacione të nevojshme për studentët në programet e studimit që ata ndjekin, janë gjithashtu kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, të tranferimit, si dhe ekuivalentimi i studimeve, të cilat afshohen në

tabelën e njoftimeve dhe në faqen e internetit të UNIKO-s.

Syllabuset e moduleve mësimore u bëhen të njohur studentëve nga pedagogët në fillim të çdo moduli mësimor. Ato janë të përgatitura në shqip dhe anglisht, janë të miratuara dhe depozituara në Departamentet perkatese. Syllabuset përmbajnë informacione të detajuara për secilën lëndë, konkretisht në lidhje me objektivat e vendosura dhe kompetencat e synuara për tu arritur; tematikat e trajtuara gjatë leksioneve dhe seminareve; komponentët formues brenda dhe jashtë auditorit; frekuentimi i lëndës; format e matjes së njohurive të studentëve, të motivimit të pjesëmarrjes së tyre, si dhe të vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar të studentëve.

DSHS ka të arshivuar të gjithë programet lëndore (syllabuset) të moduleve që zhvillohen në programet e studimit. Ato janë përditësuar sipas formatit të VKM 41 dhe pasqyrojnë të gjithë komponentët mësimorë. Duke konsideruar periudhën 3-vjeçare të raportimit për efekt akreditimi, DSHS disponon edhe silabuset e mëparshme sipas formatit të UNIKO, informacioni i hollësishëm ky për sa i takon përmbajtjes së leksioneve, praktikave dhe seminareve. 59 Dosja e plotë e silabuseve për programet e studimit është në përditësim të vazhdueshëm dhe motivon pedagogët të përmirësojnë sistematikisht pjesë të programit apo të referencave. Silabusi miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe zëvendëson silabusin e mëparshëm në dosje.

Shtojca

5 Për më shumë shih rregulloren e programeve të studimit per FSHNH

56 Për më shumë rreth planit të detajuar mësimor të programit të studimit “Administrim dhe politika sociale” shih shtojcën 2.7

57 Një shembull ilustrues për transferimin e studentit dhe ekuivalentimin e studimeve gjendet në shtojcën 4.5.

58 Syllabusat e lëndëve në gjuhën shqipe, si dhe ato të shkurtuara në anglisht gjenden në faqen e internetit ESSE3, në profilin e pedagogëve. Faqja e internetit ESSE3 gjendet në linkun nr.

5.7. <https://www.unkorce.esse3.ugov.rash.al/Home.do>

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

III - PERSONELI I NJËSISË SË INSTITUCIONIT

Standardi III.1 - Njësia e institucionit ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit

Elementë referues të raportit

- Procedurat ligjore dhe transparente: të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren; të vlerësimit të personelit.
- Së paku 70% e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë është i punësuar me kohë të plotë;
- Raportet e rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.

Analiza

Tabela .., faqe..

Shtojca

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi III.2 - Njësia e institucionit disponon një bazë të dhënash për personelin e tij

Elementë referues të raportit

- Baza e të dhënave të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programeve të studimit; lista e plotë e personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;
- Angazhimi i personelit akademik që ka së paku titullin Prof. /Prof.as.dr⁶ si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimit të ciklit të parë.

Analiza

Në FSHNH funksionojnë 16 programe studimi aktive, të organizuara në dy cikle, 8 programe studimi bachelor, 7 programe studimi master dhe 1 program me karakter profesional 2-vjeçar:

Fakulteti ka 50 pedagogë me kohë të plotë, në të cilët 2 pedagogë me titullin profesor-doktor (Prof.dr), 1 pedagog me titullin profesor-doktor (Prof.dr), 2 docentë dhe 26 me titullin Doktor i Shkencave (2 prej të cilëve PhD.). Gjithashtu, ka 74 pedagogë me kohë të pjesshme. Më poshtë vijojnë në mënyrë më të detajuar.

- Departamenti i shkencave sociale angazhon 12 pedagogë me kohë të plotë, në të cilët 1 pedagog me titullin profesor-doktor (Prof.dr), 8 doktorë (1 ndër të cilët PhD) dhe 1 docent. Gjithashtu, ka 16 pedagogë me kohë të pjesshme.
- Departamenti i infermierisë angazhon 11 pedagogë me kohë të plotë, në të cilët 3 doktorë dhe 1 docent. Gjithashtu, ka 27 pedagogë me kohë të pjesshme.
- Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë angazhon 7 pedagogë me kohë të plotë, në të cilët 6 doktorë. Gjithashtu, ka 3 pedagogë me kohë të pjesshme.
- Departamenti i Informatikës angazhon 7 pedagogë me kohë të plotë, në të cilët 3 doktorë. Gjithashtu, ka 13 pedagogë me kohë të pjesshme.
- Departamenti i Matematikë-Fizikës angazhon 12 pedagogë me kohë të plotë, në të cilët 1 pedagog me titullin profesor-doktor (Prof.dr) dhe 6 doktorë. Gjithashtu, ka 15 pedagogë me kohë të pjesshme.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi III.3 - Njësia e institucionit angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij

UNIKO i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme.⁷ Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs.⁸ Në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv gjenden gjenden dosje të aplikantëve për punë, të komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe njoftimeve për punë.⁹ Sa i takon vlerësimit të performancës, pedagogët i nënshtrohen vlerësimeve nga drejtuesit e njësisë, por edhe gjatë vitit akademik duke përfshirë edhe vlerësimin nga studentët nëpërmjet pyetëso-rëve. Departamentet zhvillojnë periodikisht vlerësime të stafit akademik dhe mbajnë një bazë të dhënash për raportet e rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë etj.^{10, 11};

Departamentet për programet dhe lëndët që menaxhojnë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mbajnë të dhëna të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e punësimit, ngarkesën që mbulon.

Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik ; të cilat i ka të parashikuara në dokumente që rregullojnë veprimtarinë e tij.

Të gjithë departamentet kanë angazhuar si titullarë të lëndëve/moduleve për Programet e studimit të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku titullin Prof. /Prof.as.dr.

Në strukturën organizative janë përfshirë staf ndihmës mësimor dhe IT lidhur me angazhimin maksimal në funksion të ecurisë së punës dhe përmbushjes së objektivave. Kjo është parashi-kuar si në organogramën e fakultetit, ashtu edhe në rregulloren e studimeve. Stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimin.

Gjithashtu personeli administrativ është gjithmonë në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarë-vajtjen e procesit akademik.^{12,13}

Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale FSHNH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike(DAR/ZA) (Bashkia Korçë) për të garantuar zhvillimin e praktikave në institucionet vartëse të tyre (shkolla të mesme) (zyrat e administratës publike).¹⁴ Përveç praktikave në institucione, studentët zhvillojnë dhe ekspedita mësimore. Në të dy rastet departamentet angazhojnë pedagogë që ndjekin studentët në praktika mësimore apo ekspedita. Këtë angazhim pedagogët e parashikojnë në formularin që bëjnë për ngarkesën vjetore të punës së tyre.¹⁵ Dërgimi i studentëve në praktika mësimore apo ekspedita mësimore bëhet sipas një procedure standarde midis Departamentit-Dekanit dhe në rastin e ekspeditave edhe me zyrën e prokurimeve në institucion.^{16, 17}

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

⁷ Anex III. Dok. 3.1..Statuti UNIKO, Neni 40 <https://www.unkorce.edu.al/statuti-i-universitetit>

⁸ Anex III. Dok. 3.2..<http://www.app.gov.al> Buletini Nr. 40 datë 09 Tetor 2017; <http://www.app.gov.al> / Buletini Nr. 39 datë 01 Tetor 2018

⁹ Anex III. Dok. 3.3. Praktikë e dosjes së stafit nga burimet njerëzore **shembull**

¹⁰ Anex III. Dok. 3.4. Praktika e vlerësimit të stafit nga drejtuesit e njësisë. **shembull**

¹¹ Anex III. Dok. 3.5. Procedura e rekrutimit që lidhet me departamentin

¹²Anex III. Dok. 3.10. Rregullore UNIKO. Neni 3 Struktura organizative; Neni 4, Pika B

<https://www.unkorce.edu.al/sq/rregullore-e-organizimit-dhe-veprimtaris%C3%AB-m%C3%ABsimore-k%C3%ABrkimore-shkencore-e-universitetit-%E2%80%9Cfan-s-noli%E2%80%9D>.

¹³ Anex III. Dok. 3.11. (Rregullorja ESSE3)

http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/Rregullore%20per%20ESSE3_%20update%2019_4_2017.pdf

¹⁴ Anex III. Dok. 3.12. Model marrëveshjeje bashkëpunimi midis FSHNH dhe Bashkisë Korçë për zhvillimin e praktikave profesionale

¹⁵ Anex III. Dok. 3.13.Model i organizimit të ngarkesës vjetore të punës së pedagogut ku përfshihet praktika mësimore apo ekspedita në terren;

¹⁶Anex III. Dok. 3.14.Model i shkresës përcjellëse pranë DAR/ZA-ve dhe listës së studentëve që dërgohen për praktikë në shkollat e mesme

¹⁷ Anex III. Dok. 3.15.Model i procedurës për zhvillimin e ekspeditave mësimore të studentëve të programit Bachelor (Biologji-Kimi)

Standardi III.4 - Njësia e institucionit angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij

Elementë referues të raportit

- Programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor; Bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.

Analiza

Kërkimi shkencor në FSHNH gjatë vitit akademik 2021-2022 shënoi rezultate relativisht të kënaqshme, koncretisht 3 projekte, me angazhimin e 7 pedagogëve të FSHNH-së; 62 pjesëmarrje dhe kumtesa në veprimtari shkencore, brenda dhe jashtë vendit, si dhe 21 botime nga pedagogë të FSHNH-së. Gjithashtu, për sa i përket kapaciteteve logjistike në FSHNH, këtë vit u ndërtua një laborator informatike dhe një tjetër u riorganizua. Angazhimi në veprimtaritë kërkimore-shkencore dhe kualifikimi i vazhdueshëm janë pjesë e rëndësishme e punës së pedagogut. Rritja e cilësisë së mësimdhënies ka për bazë edhe arritjet në punët kërkimore-shkencore të realizuara nga pedagogët e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. FSHNH është i angazhuar maksimalisht për të nxitur kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij. Ai mbështet zhvillimin e konferencave shkencore nga njësitë Në mënyrë të detajuar, dhe siç u përmend edhe në rubrikën II), pjesëmarrja e pedagogëve mund të përshkruhet si më poshtë vijon:

Konferenca ndërkombëtare – 30 Kumtesa

- Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë: 6 kumtesa
- Departamenti i Shkencave Sociale: 12 kumtesa
- Departamenti i Infermierisë: 4 kumtesa
- Departamenti i Matematikës dhe Fizikës: 6 kumtesa
- Departamenti i Informatikës: 2 kumtesa

Konferenca kombëtare – 2 kumtesa

- Departamenti i Shkencave Sociale: 2

Simpoziume – 8 kumtesa

1. Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë: 1
2. Departamenti i Shkencave Sociale: 7

Seminare – 6 kumtesa

- Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë: 1
- Departamenti i Infermierisë: 2
- Departamenti i Informatikës: 3

Lektoriume – 2 kumtesa

- Departamenti i Informatikës: 2

Workshop – 4 kumtesa

- Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë: 1
- Departamenti i Infermierisë: 3

Kongrese – 1 kumtesë

- Departamenti i Infermierisë: 1

❖ 21 BOTIME NGA STAFI PEDAGOGJIK TË FSHNH

Tekste - 1

Departamenti i Matematikës dhe Fizikës: 1

Monografi - 3

Departamenti i Shkencave Sociale: 1

Departamenti i Matematikës dhe Fizikës: 2

Dispenca - 7

Departamenti i Shkencave Sociale: 1

Departamenti i Infermierisë: 6

Artikuj - 6

Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë: 1

Departamenti i Infermierisë: 1

Departamenti i Matematikës dhe Fizikës: 4

Publikime - 4

Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë: 1

Departamenti i Shkencave Sociale: 2

Departamenti i Matematikës dhe Fizikës: 1

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Në FSHNH vëmë re një përpjekje serioze për të ngritur një sistem të përzgjedhjes së personelit akademik bazuar mbi kritere transparente dhe të meritokracisë. Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe vlerësimit të performancës së personelit akademik, si në aspektin e mësimdhënies, ashtu edhe sa i përket veprimtarisë kërkimore shkencore dhe kualifikimit të mëtjshëm. Këta elementë janë pjesë e kontratës së pedagogut.

IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE

Standardi IV.1 - Njësia e institucionit ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj

Elementë referues të raportit

- Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.
- Propozimi i kritereve të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve nga Institucioni i Arsimit të Lartë.

Analiza

Qëllimi themelor i FSHNH-it në fushën e mësimdhënies është transmetimi tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter teorik ose praktik, duke mbajtur parasysh formimin e kompetencave të studentëve. Pra, synohet përgatitja e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të debatojnë e marrin vendime të sakta, si dhe të orientohen menjëherë përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen.

Ky objektivi realizohet:

(1) duke përpunuar e zgjedhur programe disiplinash sa më cilësore për çdo lëndë e që zhvillohet në FSHNH;

(2) duke përdorur si literaturë bazë dhe plotësuese libra, autorë dhe shtëpi botuese nga më të spikaturat e fushës, të njohura në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

(3) nëpërmjet zhvillimit të leksioneve dhe seminareve me metoda e forma didaktiko-pedagogjike moderne e interaktive, duke përdorur gjerësisht prezantimet problemore, analizën logjike e sasiore, analizat krahasuese e kontekstuale, pjesëmarrjen aktive të studentëve në leksione e seminare, debatin e improvizuar, etj.

Programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të afishuara në këndet përkatëse të fakultetit, pranë departamenteve, në mjedise publike dhe gjithashtu gjenden edhe në faqen e internetit të UNIKO sipas fakulteteve përkatëse.¹⁸ Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion programi i të gjitha lëndëve që do të zhvillohen, ku janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. Kjo gjë është e parashikuar dhe në sylabuset e lëndëve.¹⁹

ShtojcaAnex VII. Dok. 7.30.<https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit>

¹ Anex VII. Dok. 7.31. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve . Model sylabusi për lëndën për secilin cikël studimi

¹⁸ Anex VII. Dok. 7.30.<https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit>

¹⁹ Anex VII. Dok. 7.31. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve . Model sylabusi për lëndën për secilin cikël studimi

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

GVB vlerëson se studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Çdo fillim viti atyre u vihet në dispozicion program i lëndëve që ofrohen (silabuset). Këto programe afishohen nga departamenti në vende të dukshme. Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të universitetit www.unkorce.edu.al. Konstatohet një ndarje e balancuar e ngarkesës mësimore nëpër semestra dhe nga njëri vit në tjetrin. Lëndët gjithashtu janë të organizuara në tipologji, ku lëndët e një karakteri të mirëfilltë teorik kanë më shumë leksione në auditor, ndërsa lëndët me karakter praktik kanë ngarkesë më të lartë të orëve të seminarit dhe orëve për projekte/detyra/ushtime. Ky organizim shërben për të rritur nivelin e mësimnxënies së studentëve, pasi lehtëson përvetësimin e informacionit, duke iu përshtatur natyrës së lëndës.

Standardi IV.2 - Njësia e institucionit informon studentët në lidhje me politikat e punësimit

Elementë referues të raportit

- Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimeve; vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;
- Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës; informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Analiza

